

No. _____

Date, __, __, __

KONTRATË BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje nënshkruhet midis Drini Hotels, pjesë e Drini Travel shpk (TOUR Operator) i referuar mëposhte si Furnitori dhe Agjencia.

FURNITORI: Drini Travel shpk, Nr biz. 812231520 me pronar dhe përfaqësues ligjor
z. Sokol Berisha

Adresa: Rr. Bill Clinton Nr. 139, Prishtine ,Tel: +383 48 166 152

Email: info@drinitravel.com

web: www.drinitravel.com

E-mail: info@drinihotels.com

web: www.drinihotels.com

Dhe

AGJENCIA TURISTIKE _____ me nr. NIPT _____ dhe

Përfaqësues ligjor _____ Adrese: _____

Tel _____ Cel: _____, E-mail _____

Duke parashtruar se:

1. “**Drini Travel**” shpk I ofron agentit Online në www.drinihotels.com dhe www.drinitravel.com shërbimet e mëposhtme : Flututime, Hotele, Makina me Qera, Trasnferta dhe Ture ditore.
2. Këto shërbime individuale kompania i ofrohen agentit nëpërmjet një profili të dedikuar B2B në online platformat: www.drinitravel.com për bileta si dhe www.drinihotels.com, për hotele si dhe transfere, për tregun Kosovar, Shqiperi, Maqedoni e veriut dhe Mali i zi.
3. Agjenti nëpërmjet këtij profili do të përfitoj çmimet preferenciale për agjensite partnere.
4. Çmimet e përfituara Online në www.drinihotels.com do të ofrohen NETO për agjencitë.
5. Agjencia nëpërmjet profilin të agentit mund të vendosi në menyre të pavarur fitimin e saj për çdo shërbim që ofron te klienti i saj.
6. Çmimet për çdo shërbim janë online dhe janë subjekt ndryshimi në varësi të disponibilitetit.
7. Çdo shërbim i konfirmuar në platformat e cekura më lartë duke pranuar dokumentin e konfirmimit(bilete ose Voucher) do të mbaj logon dhe të dhënat e agjencise.
8. Agjensitë që nënshkruajnë këtë marrëveshje duhet të zbatojnë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga kjo marrëveshje.
9. Për të nënshkruar këtë marrëveshje Agjencia duhet të ngarkoj online dokumentacionin e mëposhtem mbështetës për hyrjen në fuqi të kontratës:
 - a) Çertifikaten e regjistrimit të agjencise (NIPT) si dhe logon e saj,
 - b) Nr e dokumentit identifikues të Administratorit të Agjencise.
 - c) Kontratë e bashkëpunimit e firmosur

- d) Të dhenat dhe kontaktet e agjencise
10. Agjencia do të mbaje përgjegjesi të plotë për rezervimin e kryer për çdo shërbim; hotel, fluturim, transferte , eskursion apo makine me qera, destinacioni përzgjedhur apo çdo të dhënë tjetër të vendosur gabim në një rezervim.
11. Agjencia do të mbaj Furnitorin të mbrojtur nga ankesat e klienteve të saj për çdo gabim apo incident të kryer nga agjencia.

Palet bien dakord si mëposhte:

OBJEKTI I KONTRATËS

Qëllimi i kësaj kontrate është ofrimi i të gjithë shërbimeve Online të përmendura në pikën 1, për agjencitë turistike të cilat regjistrohen si përdorues të ligjshëm të faqes www.drinihotels.com sipas kushteve dhe detyrimeve të vendosura.

MËNYRA E REGJISTRIMIT

Mundësitë e regjistrimit si agjenci anëtare janë: a) nëpërmjet aplikimit direkt në faqen e internetit www.drinihotels.com; për hotele dhe www.drinitravel.com; për bileta ose b) duke dërguar një kërkesë bashkepunimi në adresën info@drinihotels.com ; për hotele dhe info@drinitravel.com për bileta.

Në momentin e dorëzimit të dokumenteve të kërkuara, agjencisë do ti jepet një emër përdorimi dhe fjalëkalimi fillestar me të cilat mund të logohet në profilin e platformës www.drinihotels.com për ti mundësuar të drejtën e hyrjes në faqen e internetit si agjenci, si dhe për të përfituar çmimet speciale si agjenci anëtare.

Llogaria e hapur për agjencinë, nuk duhet të përdoret dhe as të transferohet në një palë të tretë. Për arsye sigurie furnitori ka të drejtë edhe të ndryshojë fjalëkalimin e llogarisë së agjencisë. Agjencia duhet të njoftojë furnitorin në rast largimi nga puna të stafit të saj i cili ka të drejtë përdorimi në sistem.

Çdo kërkesë për shërbim nga agjencia duhet të procedohet nga vet stafi i saj direkt online në www.drinihotels.com ; info@drinihotels.com tek profili i agjencionit partner.

Mbas regjistrimit dhe nënshkrimit të kontratës Agjencise i ofrohet trajnimi falas, këshillim, ose videoprezentim për stafin e saj për përdorimin e platformës në çdo shërbim online.

MËNYRAT E PAGESËS

Për shërbimet ONLINE te www.drinihotels.com; & www.drinitravel.com agjencia mund të vendosë të paguajë në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) Pagesë me Kartë Krediti / Debiti
- b) Pagesë me transfertë bankare
- c) Parapagim avans. (Agjencia depoziton shumën fillestare prej 1000 Euro, në llogarinë e Drini Travel shpk, e cila do të konvertohet në kredite të cilat mundësojnë kryerjen e rezervimeve online menjëherë)

Detajet e llogarive bankare:

Procredit Bank

Emri: Drini Travel SH.P.K
Monedha: EUR
Nr i llogarise: 1110359544010145

Raiffaisen Bank

Emri: Drini Travel SH.P.K
Monedha: EUR
Nr i llogarise: 1501200000899791

TEB Bank

Emri: Drini Travel SH.P.K
Monedha: EUR
Nr i llogarise: 2014000253915238

Për të gjithë shërbimet që agjencia dëshiron të rezervojë dhe të konfirmojë menjëherë rezervimin i duhet të kryejë menjëherë pagesën, në një nga mënyrat e poshtëpërmendura, në mënyrë që të krijojë dokumentet e nevojshme të rezervimit. Në të kundërt rezervimi i agjencisë do të jetë në statusin **“I pakonfirmuar”**.

Drini Travel & Drini Hotels dhe Agjencia bien dakord si më poshtë:

1. **Për rezervime me early booking (rezervim i hershëm):** Agjencia detyrohet të kryejë pagesën 30 % të saj brenda dhe jo më vonë 24 orëve nga momenti i rezervimit;
2. **Për rezervime normale:** pagesa e Shërbimit Turistik të shitur do të shlyhet brenda dhe jo më vonë se afatet e mëposhtme:
 - i) 30 % e shumës totale parapagim maksimumi 24 orë nga momenti i rezervimit;(ne rast mos pagimi sistemi online e anulon rezervimin)
 - ii) 70 % e shumës së mbetur të paktën 12 (dymbëdhjetë) ditë kalendarike ose me shumë përpara ditës së planifikuar të udhëtimit;
3. **Për rezervime të kryera nga 12 (dymbëdhjetë) ditë kalendarike deri 1 (një) dite përpara udhëtimit,** ose për **rebooking (rezervim rishtazi):** Agjencia do të shlyejë 100% të shumës totale të Shërbimit Turistik në momentin e rezervimit.

Gjatë rezervimit në faqen e internetit agjencisë i jepen disa mundësi pagese nëse rezervimi nuk është brenda afatit të anulimit i cili specifikohet shumë qarte në seksionin **POLITIKA E ANULLIMIT** në çdo shërbim.

- Mundësia e parë është me **kartë Krediti ose Debiti**. Më këtë mënyrë ju paguani menjëherë ONLINE dhe në momentin e konfirmimit ju keni te drejtë te krijoni dokumentet e rezervimit, (Voucher për hotel, biletat elektronike, si dhe të shikoni faturën tuaj të rezervimit).
- Mundësia e dytë është “**Me para në dorë**” dhe “**Në pritje**”: Nëse itinerari juaj nuk është në periudhën e anulimit ju do t’ju shfaqen këto mundësi pagese. Ju mund të kryeni rezervimin duke zgjedhur një nga këto mundësi por rezervimi juaj do të qëndrojë në statusin “**në pritje**” deri në momentin e konfirmimit të pagesës. Limiti i krediteve tuaja nuk do të ndryshojë nëse keni zgjedhur këto mundësi. Ju mund të paraqiteni në zyrat e **Drini Travel shpk** për të paguar faturën e rezervimit tuaj apo të kryeni nje transfertë bankare. Në këtë moment në sistemin tuaj ju mund konfirmoni itinerarin tuaj dhe të krijoni dokumentet e konfirmimit të rezervimit.
- Mundësia e përdorimit të **krediteve**: Nëse agjencia zgjedh këtë mundësi pagimi rezervimi juaj do të konfirmohet dhe dokumentohet menjëherë. Shuma e rezervimit do të zbritet nga depozita e juaj.

PROCEDURA E REZERVIMIT

Nëpërmjet sistemit në web faqen www.drinihotels.com agjencia mund të kryejë rezervime te hotelit, transferit, rentimin e automjetit si dhe ne vijim biletat e trenit, ndërsa biletat e avionit per europe në sistemin tonë www.drinitravel.com , mund ti konfirmojë rezervimet duke kryer pagesën online, si dhe të lëshojë gjithë dokumentacionin e konfirmimit për itinerarin e përzgjedhur.

Agjencia mban përgjegjësi të plotë për rezervimin që ka kryer. Numri i personave për cdo dhomë në hotel apo në cdo fluturim është i përcaktuar në momentin e shënimit të të dhënave gjatë rezervimit;

Gjatë rezervimit ju duhet të cilësoni saktë numrin e personave që udhëtojnë, moshën e saktë të fëmijës në momentin e udhëtimit, pasi politikat e furnitorëve variojnë sipas moshës së fëmijës. Shërbimet e ofruara të çdo hoteli ndryshojnë nga një shtet në tjetrin në varësi të rregullave përkatëse. Ndersa per fluturimet politikat e fluturimet ndryshojne sipas operateve qe ne bashkepunojme dhe linjave ajrore. Eshte përgjegjësi e plotë e agjensionit vendosja me saktësi e të dhënave gjatë procedurës se vendosjes se te dhënave per rezervim.

- Rezervimet e hoteleve

Në momentin e konfirmimit të rezervimit të një hoteli, dhe kryerjes së pagesës agjencia ka mundësi të krijojë Voucher (*dokumenti i konfirmimit të hotelit*). Voucher i lëshuar i cili tregon numrin e rezervimit, detajet tjera dhe është detyrues për paraqitjen e klientit në hotel, do të këtë të pasqyruar të dhënat e agjencisë dhe logon e saj, si dhe do të tregojë emrin e operatorit turistik i cili ka kryer rezervimin final shoqëruar me numrin e emergjencës së tij. Klienti do të përfitojë **vetëm** ato shërbime që janë shënuar në voucher.

Furnitorët mund të refuzojnë pranimin e rezervimit në rast se informacioni i dërguar për prenotim nuk është i plotë.

Hotelet mund të ndryshojnë emrin zyrtar të tyre në cdo kohë dhe kjo nuk konsiston në ndryshimin e hotelit apo modifikimin e rezervimit.

Nëse hoteli kërkon kosto shtesë për krevate ekstra, vakte ose shërbime te tjera, këto do të paguhen sipas mënyrës së kërkuar nga furnitori.

Çdo natë ekstra e shtuar pas konfirmimit të rezervimit do të konsistojë në kosto extra.

- Rezervimet e fluturimeve

Agjencia mban përgjegjësi për rezervimet e fluturimeve. Për çdo ndryshim në detajet e fluturimit nga agjencia, pas konfirmimit të rezervimit, duhet menjëherë të njoftojë stafin e Drini Travel Helpdesk per asistence.

Agjencia është përgjegjëse për informimin e klientëve për dokumentacionin e kërkuar në udhëtim (vlefshmërinë e pasaportave, vizat etj). Në çdo rast agjencia mund të konsultohet me stafin e Drini Travel & Drini Hotels për të marrë informacionin e saktë para se të procedoje me rezervimet.

Rezervimet e transferit

Derisa ne platformën www.drinihotels.com nuk eshte implementuar rezervimi direkt online i transferit per klientët nga airopoti deri ne hotel dhe anasjelltas atëherë kete shërbim agjencia mund ta marr tek kompania Drini Hotels, përmes kontakteve nga stafi i saj ose me email info@drinihotels.com dhe ne vijim pas implementimit te këtij shërbimi agjencitë kete shërbim do te mund ta bëjnë nga useri i tyre nga platforma online www.drinihotels.com duke e paguar gjithashtu online dhe pranuar konfirmimin ne emailin e tyre.

Anulimet dhe Rimbursimet ne Drini Hotels

Në momentin e rezervimit të çdo produkti ju do të verifikoni edhe njeher afatin e anulimit si dhe kostot perkatese te specifikuara ne seksionin POLITIKAT E ANULLIMIT ne sistem. Çdo kërkesë anulimi që do të vijë nga agjencia duhet te dergohet me email tek info@drinihotels.com dhe stafi pergjeges I rezervimit do tju njoftoje mbi kostot qe mund tju rimbursohen ne varesi te politikave perkatese te anulimit nga linjat ajrore, hotelet ose operatoret qe ne bashkepunojme. Anulimet dhe rimbursimet do të trajtohet në përputhje me kushtet e vendosura në momentin e rezervimit.

Në rast se gjatë kërimit të një produkti agjencia nuk është e qartë për afatet e anulimeve ose ato nuk janë të specifikuara, është përgjegjësi e agjencisë të kërkojë sqarim nga Drini Travel HELPDESK përpara se te procedojë me rezervimin.

Procedura e Rimbursimit

Kërkesat për rimbursim do të konsiderohen në përputhje me politikat e anulimit dhe afatet të vendosura nga çdo operator online, linje ajrore apo hotel në seksionin ***Politikat e Anulimit*** në profilin e agentit. Drini Travel ka për detyrë të njoftoje agjencine për kostot e rimbursimit sipas politikave të operatoreve në kohe reale. Rimbursimi sipas vleres se konfirmuar nga Drini Travel paraprakisht do ti kthehet agentit vetem kur kjo vlere ka hyre ne llogarine e Drini Travel nga operatori qe e ofron kete sherbim.

Ndryshime të tjera në rezervim

Çdo kërkesë e agjencisë lidhur me rezervimet e saj do të merret menjëherë në konsideratë nga Drini Travel. Zgjidhja e kërkesës do të jetë gjithmonë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve brenda kësaj marrëveshjeje. Pavarësisht këtyre stafi i Drini Travel & Drini Hotels do të përpiqet apo sugjerojë mënyrat më të mira për zgjidhjen e kërkesës.

Kërkesat për ndryshim në rezervim duhet të kryhen brenda afateve dhe detyrimeve të vendosura nga furnitori në momentin e rezervimit. Për çdo ndryshim pas këtij afati do të aplikohen tarifat shitesë në varësi të politikave të ndryshimeve të përcaktuara në sistem.

ANKESAT

Në rast ankese për shërbimet agjencia duhet ti drejtohet menjëher ne kohe reale Drini Travel shpk ne nr e kontaktit **+383 48 166 151**. Kjo ankese duhet menjëherë te raportohet gjithashtu dhe me nje dokument qe evidenton situaten e ndodhur ne emalin info@drinihotels.com ; Drini Travel është i detyruar të kthejë një përgjigje brenda dites duke ju vënë në dijeni të statusit momental dhe vlefshmerise të ankeses me email.

HYRJA NË FUQI

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe të plotësimit të gjithë dokumentacionit mbështetës të kërkuar nga operatori turistik dhe, ka një afat një vjeçar. Kontrata mund të rinovohet me te njëjtin afat automatikisht, nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palën tjetër 30 ditë para përfundimit të afatit të kontratës.

Palët në marrëveshje bien dakord të plotësojnë kushte dhe detyrimet e nënshkruara.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet mes palëve lidhur me sa është rënë dakord, nëse nuk zgjidhen mes palëve, do të shqyrtohen sipas legjislacionit dhe lënda do të trajtohet nga Gjykatat e Republikës së Kosovës.

FURNITORI

Drini Travel & Drini Hotels

AGJENCIA
